



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 260, datë 24.05.2023

PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË
SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR PASJE/NJOHJE TË STATUSIT TË
KËSHILLTARIT/NDIHMËSIT LIGJOR JOMAGJISTRAT
PRANË GJYKATËS SË LARTË TË Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për dy projekt-akte, mbi kërkesën për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. Fatmira Luli, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës të z. {...};

VËREN:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka qenë depozituar më datë 22.10.2020, kërkesa nga z. {...}, me anë të së cilës ai pretendonte se gëzonte statusin e këshilltarit /ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë në përputhje me parashikimet e neneve 34, 84 të ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 165, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkonte njohjen e tij nga ana e Këshillit.

2. Me vendimin nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë gjykatës së lartë të z. {...}”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër të tjera: “1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. {...}, për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”.

3. Ky vendim erdhi si pasojë e vlerësimit të faktit se kërkimi përpara Këshillit ishte për shqyrtim në të njëjtën kohë edhe përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pra, ky vendim i ndërmjetëm u konkludua duke mbajtur në konsideratë parashikimin procedural civil, konkretisht nenin 36/3, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk mund të trajtojë çështje të cilat janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor.

4. Këshillit të Lartë Gjyqësor i është komunikuar vendimi nr. 2416 (2451), datë 29.07.2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ku është vendosur pranimi i pjeshëm i padisë, detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë që t'i shpërblejë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në masën e pagës për periudhën nga data 16.09.2017-14.02.2018 dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj. Ndaj këtij vendimi, palë paditëse z. {...} paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ashtu si edhe pala tjetër e paditur, Gjykata e Lartë, kurse Këshillit i Lartë Gjyqësor nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi vendimi nr. 2416 (2451), datë 29.07.2021, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk përmbante asnjë detyrim për KLGJ-në.

5. Gjithashtu, Këshillit të Lartë Gjyqësor i është komunikuar edhe vendimi nr. 221, datë 10.03.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit me palë paditëse z. {...} dhe palë të paditura Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e sipërcituar ka vendosur:

“1. Prishjen e vendimit nr. 2416, datë 29.07.2021, të gjykatës Administrative të shkallës së Parë dhe rrëzimin e kërkesë padisë.

2. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

3. U shpall sot më datë 10.03.2023, Tiranë.”

6. Z. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën e protokolluar me nr. 5356/1 prot., datë 24.03.2023, me anë të së cilës ai heq dorë nga kërkesa e tij e depozituar më parë në datë 22.10.2020. Në kërkesën e tij z. {...} pretendon: *“...Duke qenë se tashmë ka përfunduar gjykimi në të dyja shkallët e tij, heq dorë nga kërkesa drejtuar para jush në vitin 2020 dhe pushimin e shqyrtimit të saj...”*.

7. Me vendimin nr. 259, datë 24.05.2023, *“Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur ndër të tjera: *“1. Shfuqizimi i vendimit të pezullimit me nr.642, datë 23.12.2020, të KLGJ-së “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}”*.

II. KONKLUZIONE

8. Në vendimin nr. 642, datë 23.12.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur “1. *Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. {...}, për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...*”, në referim të parashikimit procedural civil, sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.

9. Në kushtet kur vetë kërkuesi z. {...} ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga kërkesa për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 259, datë 24.05.2023 vendosi shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “*Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}*”, në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi jemi në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së tij kanë pushuar së ekzistuari.

10. Në datë 24.03.2023, kërkuesi z. {...} ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesë për heqje dorë nga kërkesa shqyrtimin për pasjen/njohjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë. Sipas nenit 90 dhe nenit 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshillit i duhet që të disponojë lidhur me përfundimin pa vendim përfundimtar të kërkesës së mësipërme, pasi në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 165, të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenet 63, 97, 98 dhe 100, të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, në nenin 90 dhe nenin 94/1, e vijues të Kodit të Procedurës Administrative dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 259, datë 24.05.2023, “*Për shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}*”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. {...}, për shkak të heqjes dorë nga kërkesa.
2. Një kopje e vendimit t'i njoftohet z. {...}.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR